



Datë: 04.03.2026
Numër Protokoll: 1133/2026

A.nr.28/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-Kryetar, Eshref Shabani dhe Arditë Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.28/2026 të datës 12.01.2026, të parashtruar nga ankuesi M.K, nga Obiliqi, kundër organit të punësimit: Komunës së Obiliqit, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa A.nr.28/2026, e datës 12.01.2026, e parashtruar nga ankuesi M.K.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, M.K (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja*), me datë 12.01.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës , për shkak të shkeljes së Ligjit për Zyrtarët Publikë, Ligjit të Punës, Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në raport me heshtjen administrative të Kryetarit të Komunës së Obiliqit lidhur me kërkesën e datës 10.12.2025, ku është kërkuar të anulohet vendimi dhe akt emërimi i lëshuar nga Kryetari për Udhëheqës të Qendrës për Punë Sociale, të ushtroj detyrat ku nën mbikëqyrje të kem edhe katër punëtor dhe hyjë në pagë si drejtues i ulët.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.01.2026 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Obiliqit, ndërsa, Këshilli më datë 27.01.2026, ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 10.02.2026 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:741/2026, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjën A.nr.28/2026 të datës 12.01.2026 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së ankesa e ankuesit, **është e parakohshme, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi fillimisht sipas Akt Emërimit me numër protokolli II/10, të datës 03.02.2014, është punësuar në pozitën Udhëheqës i Shërbimeve Sociale në Komunën e Obiliqit, ndërsa më datë 21.08.2025, të njëjtit i është lëshuar Akt Emërimi me Nr.02-110-03-24146/25, për pozitë të njëjtë me mandat katër (4) vjeçar.

Kryetari i Komunës së Obiliqit më datë 05.09.2025, ka nxjerr Vendim me Nr. 02-110-03-26610-25, për transferimin e përhershëm të znj. F.H nga pozita Udhëheqës i Sektorit të Ndihmave Sociale në pozitën Udhëheqës i Qendrës për Punë Sociale, ndërsa si rezultat i këtij vendimi më datë 10.09.2025 i është lëshuar Akt Emërimi me Nr. 02-110-03-27193-25 për pozitën Udhëheqës i Qendrës për Punë Sociale me mandatë katër (4) vjeçar.

Ankuesi më datë 10.12.2025, i është drejtuar me kërkesë Kryetarit të Komunës dhe Zyrës së Personelit të Komunës së Obiliqit, me të cilin ka kërkuar, anulimin e vendimit dhe akt emërimit të lëshuar nga Kryetari për Udhëheqës të Qendrës për Punë Sociale, të ushtroj detyrat ku nën mbikëqyrje të kem edhe katër punëtor dhe hyjë në pagë si drejtues i ulët, pasi mbaj pozitën Udhëheqës i Shërbimeve Sociale.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se me nxjerrjen e vendimit për transferim të përhershëm të znj.F.H në pozitën Udhëheqës i Qendrës për Punë Sociale dhe lëshimi i akt emërimit për këtë pozitë, janë shkelur parimet ligjore e si rezultat më janë marr edhe kompetencat tjera që i kanë pasur. Pretendon se Kryetari i Komunës së Obiliqit ka heshtur karshi kërkesës së datës 10.12.2025. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet akt emërimit me të cilën znj.F.H është emëruar në pozitën Udhëheqës i Qendrës për Punë Sociale, të ndalohen veprimet e kundërligjshme që cenojnë kompetencat e mia dhe të zbatohet ligji përkatës që të bëhet kompensimi i pagës sipas pozitës që mbaj.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: “1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ...”, e në kuptim të këtyre*

dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 12.01.2026 është e parakohshme, pasi që ankuesi ende pa kaluar afati ligjor për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar sipas kërkesës së datës 10.12.2025 dhe rrjedhimisht ende pa u përmbushur kriteri kohor lidhur me heshtjen administrative parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj, mbi këtë bazë konstatimi, Kolegji vlerëson se ankesa e ankuesit është pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në kontekst të mbrojtjes së të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji thekson faktin se hedhja poshtë e ankesës A.nr.28/2026, nuk nënkupton mohimin e së drejtës së ankuesit që i njëjti sërish mund të ushtroj ankesë në pajtim me afatet e përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.28/2026, datë 04/03/2026.

Avdyll BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit M.K;
- Komunës së Obiliqit (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.